

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, ZNJ. BLERONA HASA

07/27/2020

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 23.7.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. Blerona Hasa bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, në datën 27.7.2020, vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Blerona Hasa, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga z. Olsi Komici, znj. Brunilda Bektoshi relatore, znj. Xhensila Pine anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.